



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 396/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha, dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Fushë Kosovë, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Fushë Kosovë, me të cilën pretendohet se më 29.10.2013 në ora 13:15 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur posterët e Aleancës Kosova e Re që ishte ngjitur në strukturën publike në Rr. Nëna Terezë, konkretisht në shtyllat e telekomunikimit të PTK-së. Parashtruesi i ankesës thekson se duke qenë se struktura në fjalë është nën pronësi publike, ngjitja e materialit zgjedhor është në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi dhe posterë e ngjitur janë të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal të subjektit politik AKR. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe nenit 3.4 pika b të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se posterit i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal të subjektit politik AKR që është vendosur në pronësi publike, nuk qëndrojnë sepse nuk është ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se ku gjendet shtylla në fjalë dhe se a është në pronësi publike siç supozohet në ankesë, me këtë rast vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e

supozuar. Andaj në kuptim 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 396/2013 më datën 01.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*